



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2023:088084

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05502102

**PPP.nr.10/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË –Dega Istog, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile**, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Byroja Kosovare e Sigurimit me seli ne Prishtinë, Magjistratja Prishtinë – Fushë Kosovë, pa numër, të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson Debt Loan Recovery me adresë në rrugën “Enver Maloku”, numër 108 Prishtinë, kundër debitorit H.H nga fshati D., Komuna I., lidhur me çështjen përmbarimore sipas dokumentit përmbarimor – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega Istog, C.nr.102/16 të datës 04.02.2019, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.315/23 të datës 15.03.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 25.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET i pabazuar** prapësimi i ushtruar nga debitori H.H nga fshati D., Komuna I., kundër Urdhrit për Lejimin e përmbarimit P.nr.315/23 i datës 15.03.2023, të lejuar nga Zyra Përmbarimore – Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi nga Prishtina.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit Byroja Kosovare e Sigurimit, ka lëshuar Urdhërin P.nr.315/23 të datës 15.03.2023, me

të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarimor – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega Istog C.nr.102/16 të datës 04.02.2019, i plotëfuqishëm me datën 19.09.2022 dhe i ekzekutueshëm me datën 05.10.2022 në bazë të të cilit është urdhëruar debitori që t'ia paguajë kreditorit shumën prej 6,013.00 Euro, me kamatë ashtu siç paguajnë bankat komerciale në Kosovë, për mjetet e deponuara nga qytetarët pa destinim të përcaktuar duke e llogaritur nga data 04.02.2019 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 50 Euro.

Kundër Urdhrit të lartëcekur për lejimin e përbarimit, brenda afatit të paraparë ligjor, debitori ka paraqitur prapësim me datën 29.03.2023. Në prapësim debitori ka theksuar se në kontakt të vazhdueshëm me kreditorin ka kërkuar që shuma prej 6,013.00 euro të jetë më e ulët, pasi që debitori ka qenë i gatshëm me rata nga pensioni i tij prej 100 eurove, ta paguaj shumën prej 50 euro, meqenëse i njejti jeton nga sociali dhe mundësia që të paguaj një shumë si më lartë është e pamundur. Më tej ka shtuar se debitorit po i rrezikohet mbijetesa, pasi që jeton vetëm me një pension dhe i përket moshes së shtyer mbi 70 vite e që mundësia e tij për të punuar është e pamundur, duke propozuar që të ndryshohet propozimi për përbarim për nga vlera e përbarimit, të arrihet marrëveshje e re në mes të debitorit dhe kreditorit, ashtu që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhëri për përbarim.

Kreditori, brenda afatit ligjor nuk ka parashtruar përgjigje për prapësim.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

- prapësimi është i pabazuar për arsyet në vijim:

Dispozita nga neni 22 par.1 e LPP-së, përcakton llojet e dokumenteve në bazë të të cilave mund të caktohet përbarimi. Në nënpar 1.1 të këtij neni përcaktohet: “*Dokumente përbaruese janë: 1.1.vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbaruese*”. Në këtë funksion, dispozita nga neni 23 par.1 përcakton se: “*Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit...*”. Në anën tjetër, dispozita nga neni 24 par.1, e cila i referohet përbarueshmërisë së vendimit, parasheh që “*Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përbarueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.*” Elementet të cilat

duhet t'i përmbajë një dokument përbarimor janë të përcaktuara saktësisht në dispozitën e nenit 27 par.1 të LPP-së, ku parashihet: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.”*

Gjykata me rastin e shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës erdhi në përfundim se titulli ekzekutiv në bazë të të cilit është lejuar përbarimi, gjegjësisht, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, C.nr.102/16, i datës 30.01.2019, i përmban të gjitha tiparet e dokumentit përbarues dhe rrjedhimisht shërben si bazë për caktimin e përbarimit, ngase i plotëson kushtet ligjore në kuptim të dispozitave nga nenet 22 par.1 pika 1.1, 23 par.1, 24 par.1 dhe 27 par.1 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, për të qenë i përbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përbarim ngase i njëjti është bërë i formës së prerë me datë 19.09.2022, respektivisht i ekzekutueshëm me datë 05.10.2022. Me dispozitën e nenit 21 parashihet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Pra, në rastin konkret aktgjykimi ka shërbyer si bazë për lejimin e përbarimit.

Gjykata me rastin e vendosjes poashtu mori parasysh pretendimet e palës debitore, se të njëjtit po i rrezikohet mbijetesa, pasi që jeton vetëm me një pension dhe i përket moshës së shtyer mbi 70 vite e që mundësia e tij për të punuar është e pamundur, duke propozuar që të ndryshohet propozimi për përbarim për nga vlera e përbarimit, të arrihet marrëveshje e re në mes të debitorit dhe kreditorit, pretendime këto të cilat sipas Gjykatës i përkasin kontestimit lidhur me mënyrën e vendosjes në procedurë kontestimore, e si të tilla nuk mund t'i nënshtrohen vlerësimit nga ana e gjykatës në këtë procedurë. Procedura përbarimore udhëhiqet nga *parimi i rigorozitetit formal*, i cili e pamundëson shqyrtimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së vendosjes në instancat tjera, ngase objekt shqyrtimi është vetëm vlerësimi i dokumentit që ka shërbyer si bazë për lejimin e përbarimit.

Nga arsyet e dhëna, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo Gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar pasi që i njëjti nuk ka ofruar prova bindëse për t'i bërë të besueshme pretendimet e tij, andaj të njëjtin e refuzoi si të pa bazuar, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË ISTOG**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile**  
**PPP.nr.10/23, datë 25.03.2024**

**Gj y q t a r j a**  
Pajtesë Boshnjaku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.